



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:212189

Datë: 13.07.2020

Numri i dokumentit: 01019877

C.nr.1018/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Dardan Kadolli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh. F. nga P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Murat Demolli, rr. “Nazim Gafurri” nr. 21, Prishtinë, kundër të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, të cilin e përfaqëson Safet Thaçi, lidhur me çështjen kontestuese kompensim i pagave jubilarë, me vlerë të kontestit 4029.57€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur më 06.07.2020, kurse me datë 13.07.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh. F. nga P. dhe **DETYROHET** e paditura Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë, që paditësit në emër të tre pagave për shpërblimin jubilar t’ia paguaj shumën prej 4029.57€, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8 %, e cila do të llogaritet nga data e nxjerrjes së aktgjykimit gjegjësisht prej datës 13.07.2020 e gjerë në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën detyrimin e përmbarimit ligjor.

II. Detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) në Prishtinë, që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 279 €.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate, me datë 04.04.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti pagesën e tre pagave në emër të shpërblimit jubilar. Në padi ka theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin dhe detyrat e punës profesor në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, deri me datën 01.10.2015, ashtu që për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 20.07.2015, i ndërpritet marrëdhënia e punës. Ka shtuar se lidhur me pagesën e pagave jubilarë i është drejtuar të paditurës, mirëpo e njëjta nuk ka vendosur lidhur me kërkesën, pra nuk është refuzuar e njëjta po ashtu nuk është aprovuar. Sipas paditësit, bazuar në nenin 52 të Kontratës Kolektive, garantohet e drejta për shpërblim jubilar.

Në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësi i ka realizuar tre paga përcjellëse, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.685/16, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit, prandaj duhet t'i takojnë edhe pagat jubilarë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura nuk ka ushtruar përgjigje në padi, përkundër pranimin të aktvendimit për detyrimin për të bërë një gjë të tillë. Përfaqësuesi i të paditurës në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, e ka kontestuar kërkesëpadinë, ngase paditësi i ka realizuar paga për përcjellje në pension sipas aktgjykimit të kësaj gjykate, tashmë e paditura nuk ka obligim ndaj paditësit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata bëri administrimin e provave e si: vendimi i të paditurës me nr. 1/573, datë 20.07.2015; kërkesa për kompensimin e tre pagave jubilarë, datë 12.12.2018; vërtetimi i të paditurës me nr. 325, i datës 22.03.2016; vërtetimi i të paditurës me nr. 325, i datë 15.03.2016, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.685/16, si dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit CA.nr.5232/17; vërtetimi i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, datë 08.01.2019.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes palëve ndërgjyqësore nuk ishte kontestuese se paditësi, para moshës së pensionimit ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura nga data 01.10.1988 e deri me datë 01.10.2015, si profesor në marrëdhënie të rregullt pune.

Nga administrimi i provës vendimi i të paditurës, me nr.1/573, të datës 20.07.2015, gjykata gjeti se paditësit i është shkëputur marrëdhënia e punës meqë kishte arritur moshën e pensionimit.

Lidhur me përvojën e punës, gjykata përmes vërtetimit të të paditurës nr. 352 të datës 22.03.2016, gjeti se paditësi tek e njëjta ka 27 vite të përvojës së punës, kurse përmes vërtetimit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, datë 08.01.2019 vërtetohet se paditësi ka pasur mbi 12 vite të përvojës së punës, pra në total ai ka mbi 39 vite të përvojës së punës. Të dy këto dokumente që dëshmojnë vërtetësinë e përvojës së punës, janë dokumente të lëshuara nga institucione publike, dhe përmbajtja e tyre merret të jetë si e vërtetë, deri të vërtetohet e kundërta. Gjykata bën këtë vlerësim, ngase përfaqësuesi i të paditurës, në seancë gjyqësore, e ka kundërshtuar vërtetimin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, por pa i cekur arsyet e një kundërshtimi të tillë.

Gjykata gjeti paditësi i ka realizuar 3 paga në emër pagave për përcjellje në pension, sipas aktgjykimit të kësaj gjykate C.nr. 685/16, datë 09.10.2017, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit CA.nr.5232/2017.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi kishte punuar te e paditura si punëdhënës i fundit dhe në total kishte mbi 39 vite përvojë pune. Të njëjtit nuk i janë paguar pagesat për shpërblim jubilar në vlerë të tre pagave bazë, të parapara me nenin 52 par. 1.3 të MPKK. Mos pagesën e këtyre pagave edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor e pohoi e paditura, e cila ka pohuar se të njëjtat nuk i takojnë. Lartësinë e pagave mujore, gjykata e vërtetoi përmes Vërtetimit të lëshuar nga e paditura, me ref. 325 e datës 15.03.2016. Sipas përfaqësuesit të paditësit, ai ka realizuar pagë mujore në lartësi prej 1343.19€, prandaj duke u bazuar në nenin 2 par. 1 të LPK-së: *Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*, gjykata vendosi siç është kërkuar në kërkesëpadi.

Gjykata duke ju referuar MPKK, të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Odës Ekonomike të Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 52 është paraparë e drejta e punëtorit në shpërblim jubilar, gjeti se e njëjta është e aplikueshme në rastin konkret dhe se e paditura ka pasur detyrim që me rastin e pensionimit paditësit t'ia paguaj tre paga në emër të shpërblimit jubilar.

Gjykata, pretendimet e të paditurës i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Gjykata vë në dukje se MPKK, bën ndarjen në kategori të ndryshme të pagave jubilarë dhe për përcjellje në pension, së këndejmi pretendimi se paditësi më parë kishte realizuar të drejtat e tij, nuk qëndrojnë, ngase ai kishte realizuar pagat për përcjellje në pension, dhe jo shpërblimin jubilar.

Gjykata gjeti se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka hyrë në fuqi nga 01.01.2015 dhe e njëjta është e zbatueshme dhe në nenin 52 të saj është paraparë shpërblimi jubilar.

Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, e njëjta është e legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësi ka rolin e kreditorit kurse i padituri rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve *Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shumën si në dispozita të aktgjykimit.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8 %, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, e llogaritur nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e II të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 270 €, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104€, për një seancë 135€ sipas tarifës së OAK, kurse taksa gjyqësore në shumë prej 40€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1018/19, datë 13.07.2020**

G j y q t a r i

Dardan Kadolli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.